

ECDL për Nxënës dhe Studentë



Nxënësit dhe studentët të pajisur me aftësi për përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikuese (TIK) do të shijojnë një eksperience të pasuruar edukative dhe do të jenë të përgatitur më mirë për jetë, punë dhe mësim të mëtejshme.



Aftësitë kompjuterike janë parakusht për nivelin e ardhshëm

Në moshën 16 vjeçare puna ose universiteti nuk janë fare larg. Duke marrë parasysh konkurrencën për t'u pranuar në të dyja, ju duhet të mendoni për përgatitjen që tani.

Në të kaluarën jo të largët praktikantët mësonin dhe trajnoheshin në vendin e tyre të punës. Por, për shkak të vështirësive ekonomike dhe nevojës për të kursyer gjithkund, punëdhënësit tani presin nga stafi i ri, përfshirë këtu edhe praktikantët, që duke filluar nga dita e parë e tyre e punës ata të jenë të aftë për të punuar rrjedhshëm. Askush nuk do të ketë kohë në kompani për t'ua mësuar praktikantëve formatat e excel-it, formatizimet e dokumentit, ose funksione të ngjashme të Office-it. Aftësitë për përdorimin e softuerëve të Office-it supozohen se ekzistojnë dhe gabimet bazike nuk do të lënë përshtypje të mirë.

Dërgimi i SMS-ve dhe leximi apo editimi i statusit në facebook nuk janë të barabarta me shkathtësi digjitale. Kur të filloni studimet ju do të ndesheni me nevojën për të vet-mësuar, e që paraqet një ndryshim mjaft të madh dhe rritje në sfidën e studimeve. Stresi i shkaktuar si rezultat i afatit për përfundimin e një eseje apo detyre brenda një nate nuk ka nevojë për presion shtesë të shkaktuar nga mosnjohja e funksioneve kryesore të përpunimit të tekstit, siç është për shembull krijimi automatik i një bibliografie apo ngjashëm. Merrni këto aftësi tani dhe qasuni me besim hapave të ardhshëm.

Tweeter, SMS dhe Facebook ≠ edukim digjital

Po, ne jemi të impresionuar me aftësinë tuaj natyrore për të shpalosur albumet e Facebook-ut, ngarkimin e selfies në Instagram dhe vjedhjen e një veture të policisë në GTA. Kur aftësitë e tilla të bëhen kriter për ndonjë vend të punës, ne do të jemi të parët që do të ju përgëzojmë.

Deri atëherë do të keni nevojë për të dëshmuar njohjen e programe bazike kompjuterike.

Adoleshentët mësojnë më shpejt se të rriturit

Ka një tjetër arsye për të mos e vonuar mësimin e këtyre aftësive deri sa ta bëni hapin e parë në një zyrë. Truri juaj adoleshent është ende në zhvillim, që do të thotë se ju jeni më të shpejtë në mësim, jeni në gjendje të zhvilloni memorie dhe të memorizoni më shumë informata se sa një i rritur.

Shfrytëzoni këtë përparësi tani!





Pse të certifikoheni në ECDL?

Certifikata e ECDL-së ofron dëshmi të aftësitë të studentit dhe rrit vetëbesimin e tij pasi që ka arritur një standard ndërkombëtar. ECDL-ja është bërë standardi për shkathtësi digjitale në shumë sisteme edukative rreth botës. Gjithashtu, është adaptuar nga ministri të edukimit anë e mbanë botës sepse duke përdorur teknologjinë si pjesë të procesit mësimor studentët performojnë më mirë në shkollë, janë më të përfshirë, dhe më të motivuar për mësim. Jo vetëm ministritë dhe shkollat por edhe universitetet i përdorin programet e ECDL-së për pajisjen e nxënësve dhe studentëve me aftësi të duhura digjitale. Disa nga këto universitetet janë:

- Universiteti i Prishtinës
- Universiteti për Biznes dhe Teknologji
- A.U.K Training & Development Institute
- Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus"
- Universiteti AAB
- Forca e Sigurisë së Kosovës
- University of Warwick
- University of Bristol
- University of Southampton
- University of Manchester
- University of Nottingham
- Cardiff University
- University of Sheffield
- University of Glasgow



Mbështetje në mësim të aftësive

Njohuritë e TIK-ut, në veçanti përpunimi i teksteve (Word-i), prezantimet (PowerPoint-i) dhe tabelat kalkuluuese (Excel-i), ju mundësojnë nxënësve dhe studentëve t'i prezantojnë rezultatet e punës së tyre në mënyrë profesionale. Po ashtu, me ndihmën e programeve të ECDL-së si Online Collaboration dhe Online Essentials nxënësit dhe studentët aftësohen për gjetjen, përdorimin dhe shkëmbimin e informacioneve të llojllojshme.

Duke pasuruar punën dhe mësimin me këto programe nxënësit dhe studentët fitojnë shkathtësi të mendimit kreativ dhe kritikë.

Përmirësim i komunikimit dhe bashkëpunimit

Teknologjia informative është thelbësore për rritjen e aftësive të studentëve në komunikim dhe bashkëpunim. Ajo ndihmon studentët të mësohen të punojnë së bashku – njohuri e cila duhet gjatë gjithë jetës. Duke zhvilluar shkathtësi gjithëpërfshirëse digjitale, nxënësit dhe studentët zbulojnë si ta përdorin teknologjinë për komunikim me profesorë, shokë, për të ndarë detyra dhe për të punuar në grupe.




Mbrojtja e të dhënave personale është jetësore

Përveç që ju ndihmojnë gjatë shkollimit dhe ju bëjnë më produktivë në punë, njohuritë e fituara me ECDL ju ndihmojnë të mbronin të dhënat të cilat i ruani në pajisjet tuaja personale dhe në sistemet për ruajtje online të të dhënave.

Përveç kësaj, nxënësit dhe studentët mësojnë se si të përdorin internetin në mënyrë të sigurt dhe të menaxhojnë të dhënat dhe informatat në mënyrë të duhur.





Bëhuni Artist Digjital

Grafika dhe imazhet profesionale janë vendimtare në diferencimin e punës kreative prej të tjerëve.

Duke mësuar Web-, Image- dhe Video Editing nxënësit dhe studentët bëhen dizajnerë të përkryer. Duke përdorur në mënyrë të lehtë dhe zbavitëse veglat dhe artin e editimit të fotografive, videove dhe web-it, nxënësit dhe studentët do të mund të krijojnë atë çfarë dëshirojnë.

Duke mësuar aftësi kompjuterike, nxënësit dhe studentët jo vetëm që punojnë me vegla që mbështesin edukimin e tyre, por këto aftësi gjithashtu ju nevojiten për sukses në karrierë dhe në jetën e përditshme në shoqërinë e informimit.

“Mendoja që e dija rëndësinë e ECDL-së që në fillim, por vetëm pasi që përfundova me sukses provimet e kuptova vlerën e saj të vërtetë. Mësova gjëra të reja që nuk e dija që ekzistonin dhe tani ndihem shumë më e sigurt kur ulem para kompjuterit dhe jam në gjendje të bëjë detyra nga më të ndryshmet. Nuk ka ditë që nuk shfrytëzoj diturinë e marr nga ECDL-ja dhe do të vazhdoj ta përdori gjatë gjithë jetës” – Jeta Caka, studente.

“Studentët që përfundojnë ECDL-në në shkollën e tyre kanë shanse më të mira në karrierë” – Projekt studimi nga instituti për kërkime edukative ne Hamburg, Gjermani, 2008

Për ne

ECDL Kosova është autoriteti nacional certifikues i autorizuar nga ECDL Foundation për Republikën e Kosovës. ECDL Foundation është autoriteti mbikëqyrës i programeve certifikuese, ndërkombëtarisht prijëse, të shkathëtësive kompjuterike – ECDL/ICDL. Cilësia dhe reputacioni i programeve tona certifikuese janë të ndërtuara mbi përvojën e gjatë në shpërndarjen e suksesshme të programeve certifikuese të TIK-ut miliona njerëzve anembanë botës në më shumë se 41 gjuhë të ndryshme dhe në mbi 150 shtete.

Suksesi global i ECDL-së rrjedh nga roli ynë nismëtar në identifikimin dhe zhvillimin e programeve si dhe përkushtimin tonë për të siguruar metodologji testuese që, në mënyrë të vazhdueshme, i zbatojnë standardet më të larta të cilësisë. Programet certifikuese të ECDL-së në Kosovë janë të njohura nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Universitetet Publike dhe Private dhe një numër i madh i organizatave dhe institucioneve private e publike (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Policia e Kosovës, FSK, Inspektorati Policor, Autoritetet Rregulluese, Firma e Organizata private e jo-qeveritare).

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Integritimit Evropian përmes planit për veprim PVPE 89/2 e pozicionon ECDL-në si standard certifikues për të gjithë shërbyesit civil. MASHT, duke filluar nga viti 2009 e ka përfshirë certifikimin ECDL Standard si masë obliguese për licencim për të gjithë mësimdhënësit e shkollimit para-universitar.

A mund të ju ndihmojmë?

Për çfarëdo informate shtesë jemi në dispozicionin tuaj në çdo kohë.

Ne mund të na gjeni në këtë adresë:

ECDL Kosova SH.A.

Rruga Xheladin Hana p.n. – Bregu i Diellit

10000 Prishtinë

Internet: www.ecdl-kosova.org Email: admin@ecdl-kosova.org Phone: 044-507 575